



100 Vjet Pavarësi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.2149, datë 29.08.2012

Për

“Miratimi i një shtese në Termat e Përgjithshme të Kontratës (Kontratë Tip) të Albtelecom sh.a me pajtimtarin për Shërbimin Akses në Internet nëpërmjet teknologjisë ADSL, miratuar me VKD nr. 1265, datë 28.04.2010, ndryshuar me VKD nr. 1330 dt.15.07.2010”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

| | | |
|----------------|------------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Znj. Alketa | Mukavelati | Anëtar |
| 4. Z. Benon | Paloka | Anëtar |
| 5. Znj. Zamira | Nurçe | Anëtar |

dhe sekretare Zj.M.Drushku, në mbledhjen e datës 29.08.2012, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimi i një shtese në Termat e Përgjithshme të Kontratës (Kontratë Tip) të Albtelecom sh.a me pajtimtarin për Shërbimin Akses në Internet nëpërmjet teknologjisë ADSL miratuar me VKD nr. 1265, datë 28.04.2010, ndryshuar me VKD nr. 1330, datë 15.07.2010”

BAZA LIGJORE:

1. Pika 5, neni 99 i ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);
2. Neni 15, e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Proçedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Ligji nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve” (*ligji nr. 9902*);
4. Pika 17, e nenit 21, të “Rregullores së Brendshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138, të ligjit nr. 9918,
5. Termat e Përgjithshme të Kontratës (Kontratë Tip) të Albtelecom sh.a me pajtimtarin për Shërbimin Akses në Internet nëpërmjet teknologjisë ADSL, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.1265 , datë 28.04.2010, ndryshuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP, Nr. 1330, datë 15.07. 2010;

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

V Ë R E N:

1. AKEP, bazuar në ankesat e pajtimtarëve të ndryshëm që përdorin shërbimin e Aksesit në Internet nëpërmjet teknologjisë ADSL (me paketa të limituara) ndonëse:
 - Pajtimtari mund të marrë informacionin e duhur në faqen e Albtelecom sh.a., në lidhje me shërbimin ADSL si dhe në lidhje me vlerën e arritur për M/Byte, të përfutur gjatë muajit përkatës nëpërmjet një kodi aksesit shtatë shifror, (Rubrika-Kontrolli i limitit të ADSL) .
2. AKEP, me qëllimin e mbrojtjes më të mirë të konsumatorit, bazuar në:
 - Qëllimin e garantimit të shërbimeve të duhura dhe të përshtatshme në Shqipëri, të shprehur në nenin 1 të ligjit nr. 9918, dhe
 - Objektivat rregullatore për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike, të shprehur në gërmat ‘a’ dhe ‘b’, pika 3, neni 7 i ligjit nr. 9918.

si dhe për unifikim të kontratave me ato të operatorëve alternativë që ofrojnë Shërbim Akses në Internet, konsideron dhe e vlerëson si të arsyeshme dhe të nevojshme, për të rritur shkallën e informimit të përdoruesit në mënyrë më të drejtpërdrejtë në lidhje me tejkalimin e kufizimit të përdorimit të shërbimit ADSL, shtesën të Termat e Përgjithshme të Kontratës (Kontratë Tip) të Albtelecom sh.a me pajtimtarin për Shërbimin Akses në Internet nëpërmjet teknologjisë ADSL,

3. Shtesa e propozuar në Termat e Përgjithshme të Kontratës (Kontratë Tip) të Albtelecom sh.a me pajtimtarin për Shërbimin Akses në Internet nëpërmjet teknologjisë ADSL, ka marrë në konsideratë përcaktimet ligjore të legjislacionit në fuqi në Shqipëri.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Këshilli Drejtues duke marrë në konsideratë rëndësinë e miratimit të shtesës në Termat e Përgjithshme të Kontratës për mbrojtjen e pajtimtarit, bazuar në pikën 1 të nenit 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe pika 17, neni 21 të Rregullores së Brendëshme të AKEP, e ndryshuar,

V E N D O S:

1. Të miratojë shtesën e pikës 3.1.21 në Termat e Përgjithshme të Kontratës (Kontratë Tip) të Albtelecom sh.a me pajtimtarin për Shërbimin Akses në Internet nëpërmjet teknologjisë ADSL miratuar me VKD nr. 1265, datë 28.04.2010, ndryshuar me VKD nr. 1330 dt.15.07.2010”, me përmbajtje si më poshtë vijon:

3.1.21. Për paketat tarifore që kanë tarifim të përshkallëzuar d.m.th një tarifë fikse mujore për përdorim të shërbimit “download” dhe/ose “upload” deri në një nivel të caktuar limit (kufizim), dhe mbipagesë për përdorim mbi kufizimin (tarifë për Mbyte), operatori ka detyrimin:

Të kryeje njoftimin e pajtimtarit me mjete elektronike (si p.sh. mesazh në PC) jo më pak se 3 (tre) ditë rresht kur arrihet niveli 80% i kufizimit “download”/“upload” (nëse ka të tillë) të përcaktuar në Aneksin 1 të Kontratës;

2. Ky Vendim ti njoftohet sipërmarrësit Albtelecom sh.a brenda 8 diteve nga data e nxjerrjes së tij.
3. Detyrimi i operatorit si pasojë e shtesës në Termat e Përgjithshme të Kontratës (Kontrata Tip) të sipërmarrësit Albtelecom sh.a., me Pajtimtarin për Shërbimin e Akses Internetit nëpërmjet teknologjisë ADSL, të zbatohet menjëherë.
4. Sipërmarrësi Albtelecom sh.a. të publikojë në faqen e tij të Internetit Termat e Përgjithshme të Kontratës Tip, (të ndryshuara) miratuar me këtë Vendim;

5. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. Alban KARAPICI
2. Alketa MUKAVELATI
3. Benon PALOKA
4. Zamira NURÇE